



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Komisioni i Pavarur për Media

Raporti vjetor i punës
për vitin 2009

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

shkurt 2010

Telefoni: 038 245 032

Telefaksi: 038 245 034

Ueb faqja: www.kpm-ks.org dhe www.imc-ko.org

E-mail: info@kpm-ks.org dhe info@imc-ko.org

PËRMBAJTJA:

Parathënie.....	3
Baza ligjore.....	5
Struktura e raportit	5
Objektivat për vitin 2009 dhe realizimi i tyre.....	6
1. <i>Përmbyllja e procesit të licencimit afatgjatë.....</i>	6
2. <i>Zbatimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht.....</i>	10
3. <i>Krijimi dhe adoptimi i politikës për procesin e digjitalizimit.....</i>	11
4. <i>Promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese</i>	12
5. <i>Licencimi i operatorëve kabllor në Veriun e Kosovës.....</i>	14
6. <i>Krijimi i parakushteve për përmbushjen e obligimit kushtetues për krijimin e një transmetuesi nacional në gjuhën serbe.....</i>	14
7. <i>Përforcimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane.....</i>	14
Objektivat për vitin 2010.....	14
1. <i>Përcaktimi i politikës së kalimit në platformë digjitale të mediave elektronike të Kosovës.....</i>	14
2. <i>Zhvillimi i tregut medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës.....</i>	14
3. <i>Promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese zbatimi i rregullës për.....</i>	14
<i>reklamim.....</i>	14
4. <i>Zhvillimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht.....</i>	14
5. <i>Ngritja e kapaciteteve për monitorim të programeve.....</i>	15
Kapitulli I	
Prezantim i punës së Këshillit të KPM-së	16
Takimet dhe vendimet e Këshillit të KPM-së gjatë vitit 2009.....	16
Organizimi i takimeve publike.....	17
Konferencat	18
Radio Televizioni i Kosovës – zhvillimet në 2009.....	18
Kapitulli II	
Prezantim i punës së Zyrës së Shefit Ekzekutiv.....	20
<i>Divizioni i Monitorimit</i>	20
<i>Divizioni i Licencimit.....</i>	23
<i>Divizioni Ligjor.....</i>	24
<i>Divizioni i Menaxhimit Frekuencor.....</i>	26
<i>Departamenti i Administratës.....</i>	28
Kapitulli III	
Prezantim i punës së Bordit të Ankesave për Media.....	30
<u>Shtojcat</u>	
I.	Raporti Financiar për vitin 2009
II.	Raporti i monitorimit të mediave gjatë fushatës elektorale
III.	Raporti i analizës së planit frekuencor digjital televiziv dhe alternativave
IV.	Raporti nga Konferenca për digjitalizim
V.	Tabela e rasteve ligjore të proceduara gjatë vitit 2009
VI.	Rregullorja KKPM 2009/01
VII.	Rregullorja KKPM 2009/02
VIII.	Rregullorja KKPM 2009/03
IX.	Rregullorja KKPM 2009/04

PARATHËNIE

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të një drafti të përgatitur nga Shefja Ekzekutive e Zyrës së KPM-së, është i nderuar t'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin për punën e vitit 2009, siç kërkohet nga Neni 3.8 i Ligjit Nr. 02/L-15 mbi Komisionin e Pavarur për Media.

Komisioni i Pavarur për Media, si rregullator i pavarur për rregullimin e transmetimeve elektronike në Republikën e Kosovës, është themeluar me Ligjin Nr. 02/L-15 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Mandati i Komisionit të Pavarur për Media ka të bëjë me licencimin e subjekteve transmetuese publike dhe private-komerciale, krijimin e politikave të transmetimit dhe të rritjes së cilësisë së përmbajtjeve programore, duke u bazuar në praktikat më të mira Evropiane. Gjithashtu, KPM-ja ka mandatin që të menaxhojë me Spektrin Frekuencor të Transmetimit në Kosovë.

Viti 2009 për KPM-në, konsiderohet ndër vitet e punëve më të mëdha dhe të frytshme për këtë institucion, që nga themelimi i tij. Ky vit, me siguri se do të konsiderohet si një vit vendimtar gjatë së cilit KPM realizoi disa objektiva të rëndësishme kapitale. Ndër synimet kryesore të realizuara me sukses, qysh në fillim të këtij raporti, vlen të përmenden:

- a) Plotësimi i vakumit legjislativ, saktësisht, kompletimi i legjislacionit dytësor, hartimi dhe miratimi i katër rregulloreve bazë. 1) Rregullorja për subjektet transmetuese për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore; 2) Rregullorja mbi kualifikimet për dhënien e licencës së KPM-së për transmetim; 3) Rregullorja për pajtueshmërinë me obligimet e të drejtës së autorit, dhe 4) Rregullorja për komunikimet komerciale audiovizuale
- b) Realizimi i procesit të licencimit afatgjatë të subjekteve transmetuese (radio dhe TV) si dhe ndarja e saktë vertikale e hartës difuzive në: 1. Radio-televizionet me shtrirje nacionale, 2. Radiotelevizionet me shtrirje regjionale, 3. Radio-televizionet me shtrirje lokale si dhe 4. radio-televizione me fuqi të ulët transmetimi.
- c) Hartimi i planveprimit për erën e digjitalizimit dhe organizimi i Konferencës ndërkombëtare në Prishtinë, me temën: *Prezantimi i transmetimit digjital në Kosovë dhe Regjion - STRATEGJITË*, në të cilën konferencë u trajtuan përvojat e procesit të digjitalizimit në vendet e rajonit dhe më gjerë, gjithëherë në relacione komparative me realitetin ekzistues dhe synimet e procesit të digjitalizimit në Republikën e Kosovës.

Duke u përballur me punë të rëndësishme të veçantë dhe shumë vëllimore, gjatë vitit 2009 KPM organizoi edhe tribuna e takime me karakter informativ dhe hartoi udhëzues për subjektet transmetuese për të qenë sa më objektiv, efektiv dhe të pavarur gjatë fushatës për Zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. KPM, duke u shërbyer me pajisjet *digjitale për monitorim përmbajtësor të subjekteve transmetuese* financuar nga investimi kapital përmes Buxhetit të Kosovës, ka realizuar në mënyrë permanente monitorimin e subjekteve transmetuese me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së tyre me udhëzuesit e KPM-së. KPM-së vlerëson se mbulimi i fushatës parazgjedhore për Zgjedhjet Lokale, nga ana e subjekteve transmetuese në përgjithësi ka qenë i drejtë dhe i paanshëm.

Viti 2009 ishte viti i një sfide të madhe për Transmetuesin Publik të Kosovës (RTK) i cili u përball me vështirësi financiare dhe organizative gjatë gjysmës së dytë të këtij viti. Në pajtim me Ligjin, KPM me shumë azhuritet, organizoi procesin për nominimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, dhe duke qenë pjesë përbërëse e Komisionit ad-hoc, kontribuoi në përzgjedhjen preliminare të kandidatëve për Bordin e RTK-së. KPM, gjithashtu është angazhuar me përkushtim të plotë për zgjidhjen e problemeve imediate financiare si dhe në gjetjen e një zgjidhjeje për financim të qëndrueshëm të RTK-së.

Gjatë vitit 2009, një delegacion i KPM-së realizoi takimet e para institucionale dhe hapi një dritare të vogël komunikimi me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (ITU) në Gjenevë, duke u përpjekur të sensibilizoj një logjikë mirëkuptimi të këtij organizmi ndërkombëtar karshi realiteteve të transmetuesve në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë në realitetet që do të krijohen në vendin tonë gjatë procesit të digjitalizimit.

Gjatë viti 2009, KPM ndërmori hapat e parë të cilët do t'i paraprijnë hartimit të strategjisë për digjitalizim. Themeloi grupet e punës dhe hartoi termat e referencës për këtë proces të rëndësishëm, të cilin KPM, pretendon ta përmbyll gjatë brenda viteve të ardhshme, duke synuar të realizohet brenda afatit të caktuar nga ITU dhe Komisioni Evropian. Strategjia gjithëpërfshirëse e digjitalizimit, përveç se do të krijojë hartën e përmbyllur frekuencore të transmetuesve digjital, ajo do të jetë një manual udhërrëfyes që do të krijojë hapësirë të favorshme për subjektet transmetuese në Kosovë dhe do të promovojë praktikën e krijimit të përmbajtjeve cilësore programore. Në këtë mënyrë, Komisioni i Pavarur për Media do të ndikojë që transmetuesit difuziv në përgjithësi dhe televizionet në veçanti, përfshirë transmetuesit atë publik dhe ato private, të zhvillohen profesionalisht, të ngrisin cilësinë programore, të sigurojnë mbulueshmëri me sinjal cilësor dhe financiarisht të jenë të sigurta.

Këto janë vetëm disa linja të trasha të prioriteteve dhe qëllimeve të realizuara gjatë vitit 2009. Në këtë mënyrë Komisioni i Pavarur për Media konsideron se ka realizuar me përgjegjësi, profesionalizëm, transparencë dhe mirëkuptim objektivat e saja, të përcaktuara në vitin 2008. KPM, do të vazhdojë të punojë me përkushtim në projektet ambicioze të vitit 2010, duke u përpjekur që në këto projekte, të angazhojë sa më shumë ekspertë dhe profesionistë në fushën e medias, por gjithëherë në frymën e bashkëpunimit duke i konsultuar me të gjitha subjektet relevante me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të të gjithë faktorëve relevant, publikut dhe të palëve me interes të cilët do të kontribuojnë në procesin e zhvillimit të një sektori të mirëfilltë medial.

Me këto synime, kemi kënaqësinë që Kuvendit të Republikës së Kosovës, t'i paraqesim Raportin vjetor të punës së KPM-së për vitin 2009.

Shkurt 2010

Këshilli i KPM-së, Prishtinë

BAZA LIGJORE

Më 21 prill 2005, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili ka hyrë në fuqi më 8 shtator 2005.

Komisioni i Pavarur për Media është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 3.8. të Ligjit për KPM-në, Këshilli i KPM-së përgatit dhe i paraqet Kuvendit të Kosovës, brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, një raport vjetor duke përfshirë të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave, ankesave, sanksioneve që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit dhe objektivat e projektimit për vitin e ardhshëm.

STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti i punës për vitin 2009 i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media fillon me pasqyrimin e realizimit të objektivave të vitit 2009 dhe me pasqyrim të objektivave të përcaktuara për vitin 2010. Më pastaj bëhet në mënyrë të përmbledhur prezantim i punës së Komisionit të Pavarur për Media përmes punës së Këshillit të KPM-së, Zyrës së Shefit Ekzekutiv dhe Bordit të Ankesave për Media.

Pjesë e konsiderueshme e raportimit i kushtohet procesit të licencimit afatgjatë, veprimeve të KPM-së dhe subjekteve transmetuese dhe rezultateve të nxjerra.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2009 DHE REALIZIMI I TYRE

Për vitin 2009, Këshilli i KPM-së përcaktoi 7 objektiva:

1. Përmbylljen e procesit të licencimit afatgjatë;
2. Zbatimin e politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht;
3. Krijimin dhe adoptimin e politikës për procesin e digjitalizimit;
4. Promovimin e konkurrencës së drejtë transmetuese;
5. Licencimin i operatorëve kabllor në Veriun e Kosovës;
6. Krijimin e parakushteve për përmbushjen e obligimit kushtetues për krijimin e një transmetuesi nacional në gjuhën serbe;
7. Përforcimin e bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane.

1) Përmbyllja e procesit të licencimit afatgjatë

Kjo objektive është përmbushur në periudhën kohore janar – dhjetor 2009.

Në fillim të vitit 2009, KPM ka iniciuar procesin e licencimit afatgjatë, siç është paraparë të realizohet në bazë të nenit 11.3¹ të Ligjit të KPM-së . Në përgatitjen e pakos për aplikim, me mbështetje të OSBE-së, KPM ka angazhuar dy ekspertë ndërkombëtarë nga Kompania e njohur “Albany Associates” me seli në Londër. Janë përcjellur të gjitha procedurat e parapara për këtë proces: është paraqitur për komente drafti i pakos për aplikim tek të gjithë pronarët e subjekteve transmetuese dhe janë organizuar edhe takime me subjektet transmetuese. Më 12 qershor 2009 Këshilli i KPM-së unanimisht miratoi pakon e licencimit afatgjatë në Republikën e Kosovës, pas përfshirjes së komenteve të vlefshme nga subjektet transmetuese dhe grupet tjera të interesit.

Duke filluar nga data 19 qershor 2009, KPM ka organizuar takime konsultative me subjektet transmetuese gjatë të cilave ka bërë shpërndarjen e pakos së aplikimit për licencim afatgjatë për subjektet transmetuese në të gjitha regjionet e Kosovës. Pakoja e Licencimit Afatgjatë, subjekteve transmetuese iu është shpërndarë në mënyrë fizike si dhe në formë elektronike (në CD). Me rastin e dorëzimit të pakos së aplikimit ekipet e zyrtarëve të KPM-së kanë ofruar edhe sqarimet e nevojshme subjekteve transmetuese në mënyrë që t’ua lehtësojnë procesin e aplikimit të tyre për licencë afatgjate.

Nga Këshilli i KPM-së është përcaktuar afati kohor nga data 22 qershor 2009 deri më 22 korrik 2009 që subjektet transmetuese të dorëzojnë format e aplikimit në KPM. Brenda afatit për të aplikuar për licencë afatgjate, janë paraqitur gjithsej 104 aplikacione nga 110 subjekte transmetuese që kanë operuar me licencë të përkohshme në vitin 2009.

Procesit të licencimit afatgjatë nuk i janë përgjigjur 6 subjekte transmetuese, 4 prej të cilave nuk kanë aplikuar fare:

- 1 subjekt ka bërë kërkesë për shtyrje të afatit - Radio Amadeus
- 2 janë subjekte që transmetojnë në gjuhë të minoriteteve (Radio 3 Srce dhe Radio M - Zveqan) dhe 1 multietnik (Radio Youth Voice), ndërsa

¹ Licencat e transmetimit të lëshuara nga Komisioneri i Përkohshëm i Mediave mbesin në fuqi deri atëherë kur KPM-ja të ketë një procedurë të drejtë dhe të hapur për dhënien e licencës afatgjate të përcaktuar me këtë ligj. Me miratimin e një procesi afatgjatë të licencimit nga Këshilli, të gjitha licencat ekzistuese dhe të gjithë kandidatët e rinj të kualifikuar do të merren në konsiderim për licencë afatgjatë nga Komisioni brenda gjashtë muajve nga dita e miratimit të procesit të licencimit

- 2 subjekte transmetuese kanë dorëzuar dokumentacionin e pa kompletuar dhe pas afatit (*Radio Globi dhe Radio Pandora, subjekte transmetuese që transmetojnë program në gjuhën shqipe*).

Këshilli i KPM-së iu ka ofruar edhe një mundësi subjekteve transmetuese të cilat nuk kanë arritur të aplikojnë për licencë afatgjate brenda afatit të parë, duke vendosur që data 15 nëntor 2009 të jetë afati i fundit për pranimin e aplikacioneve. Sa i përket afatit shtesë, 2 nga subjektet transmetuese në gjuhën shqipe *Radio Globi dhe Radio Pandora* kanë dorëzuar aplikacionin e pa pakompletuar. Këshilli i KPM-së, ka vendosur që, aplikacionet që dorëzohen pas datës 15 nëntor 2009, të mos shqyrtohen fare dhe të iniciohen procedurat drejt shpalljes së pavlefshme të licencave të atyre subjekteve transmetuese. KPM i është drejtuar me shkrim të gjithë atyre kandidatëve të cilët nuk kanë aplikuar fare, duke i njoftuar se për shkak të mos-aplikimit mund të mbesin jashtë procesit të licencimit afatgjatë.

Gjatë procesit të licencimit afatgjatë, është bërë verifikimi i të dhënave rreth pronësisë së subjekteve transmetuese për të vlerësuar pajtueshmërinë me rregulloren për cilësitë e marrjes së licencës (CIMC 2009/02) dhe është vërtetuar se pronarët e *Radio Drenica, Radio Ylberi, Radio Gora, Radio Hayat, Radio Sharri dhe RTV Mir*, mbajnë pronësi të subjektit transmetues në kundërshtim me Rregulloren CIMC 2009/02 për faktin se udhëheqin me parti politike apo janë të radhitur në struktura të larta politike. Në pajtueshmëri me procedurat e KPM-së, Divizioni i Licencimit ka arritur t'i zgjidhë të gjitha rastet e paraqitura më lartë rreth çështjes së pronësisë.

Klasifikimi i aplikacioneve për vlerësim

Pas verifikimit fillestar të aplikacioneve, është bërë klasifikimi i tyre duke i kategorizuar në: aplikacione të kompletuara, të kompletuara por me kërkesa për ndryshime teknike dhe aplikacione të pakompletuara të cilave iu mungonin disa të dhëna. Instalimi i filtrit dalës në transmetues ka qenë një prej kushteve kryesore teknike për t'u pajisur me licencë afatgjate.

Nga 104 aplikacionet e dorëzuara në KPM, 13 subjekte transmetuese të pajisur me filtra dalës të transmetuesit dhe dokumentacion të kompletuar janë licencuar në fazën e parë të licencimit afatgjatë.

Subjektet transmetuese të cilat janë pajisur me licencë afatgjate në fazën e parë:

Regjioni i Prishtinës: *RTK; Radio Kosova; Radio Blue Sky; KTV; TV 21; Radio 21; Radio Llapi*

Regjioni i Pejës: *TV Dukagjini; Radio Dukagjini*

Regjioni i Mitrovicës: *TV Mitrovica; Radio Kolashin;*

Regjioni i Gjilanit: *Radio Tema; TV Festina*

Pas përmbushjes së kushtit për instalimin e filtrit dalës të transmetuesit, Këshilli i KPM-së ka vendosur t'i licencojë në fazën e dytë edhe 54 subjekte transmetuese.

Subjektet transmetuese të cilat janë pajisur me licencë afatgjate në fazën e dytë janë:

Regjioni i Prishtinës: *Radio K; Radio Zëri i Shtimes; Radio Plus (për brezin FM); Radio Elit; Radio Kim*

Regjioni i Pejës: *Top Iliria Radio; Radio Gjakova; Radio Gorazdevac; Radio Peja; TV Opinion; Radio Start; Radio Hajat; Radio Fontana.*

Regjioni i Prizrenit: *Radio Malisheva; Radio Yeni Donem; Radio Omega 3; Radio Romano Avazo; Radio Prizreni; Radio Dardania; Radio Astra; Radio Gora; Radio Sharri; TV Prizreni; Radio Theranda; TV Yeni Donem*

Regjioni i Mitrovicës: *Radio Drenica; Radio Impuls; Radio Mitrovica; Radio Mix; Radio Ylberi; Radio Drenasi; Radio Mir; Radio As – Zveçan; Radio Kiss; Radio Dodona.*

Regjioni i Gjilanit: *TV Herc; Radio Herc; Radio Zëri i Pozheranit; Radio Iliria; Radio Hit Laser; TV Liria; Radio 24; Radio Kllokot; Radio Kamenica; Radio Ferizaj; Radio Max; Radio Premiera; Radio Borzani; Radio Furtuna; Radio Festina; Radio Rinia; Radio Star; Radio Kompas; TV Iliria.*

Ndërsa subjektet transmetuese të paraqitura më poshtë kanë paraqitur dokumentacionin e kompletuar mirëpo janë në pritje të instalimit të filtrit dalës

Regjioni i Prishtinës: *Top Kosova Radio; Radio Kent FM; Radio AS - Bërnice e Ulët.*

Regjioni i Pejës: *Radio Alba*

Regjioni i Prizrenit: *Bambus; Radio Vala 2000; Radio Focus.*

Regjioni i Mitrovicës: *Radio Lesak; Radio Kosovska Mitrovica; Radio Bubamara*

Regjioni i Gjilanit: *Radio Kacaniku; Radio Mega Vox.*

Këshilli i KPM-së ka lëshuar vendim për licencim me kusht për subjektet transmetuese të paraqitura më lartë. Megjithatë, në bazë të arsyetimeve të subjekteve transmetuese rreth vonesave që kanë të bëjnë me instalimin e filtrit dalës, Këshilli i KPM-së ka përcaktuar datën 28 shkurt 2010 si një afat shtesë dhe të fundit.

Subjektet me kërkesa për ndryshime në pronësi dhe në proces të vlerësimit

1. *Radio Evropa* (çështja e pronësisë, deri në fund të vitit 2009, nuk ka arritur të ofrojë sqarimet e duhura rreth pronësisë si dhe të dhënat shtesë për të kompletuar aplikacionin).
2. *Radio Gracanica* (fillimisht ka bërë kërkesë për ndryshim të pronësisë, më pas kanë vendosur që të mos e ndryshojnë pronësinë, përgatitja për lëshimin e licencës afatgjate ka qenë në përfundim në fund të vitit 2009).
3. *Radio Spektar* (kërkesë për ndryshim të pronësisë, përgatitja për lëshimin e licencës afatgjate ka qenë në proces gjatë vitit 2009).

Aplikacionet në proces të vlerësimit për fazën e tretë

Subjektet transmetuese të paraqitura më poshtë, për shkak të kërkesave teknike që ka të bëjë me ndryshime të theksueshme të parametrave teknik mbetet të merret vendim për licencim pas rezultateve të analizave teknike dhe pajtueshmërisë me planin frekuencor.

Regjioni i Prishtinës: *Radio Vala Rinore; Radio Vitez; Radio Kosova e Lirë; Radio Urban FM; Radio Anten; Radio Vizioni*

Regjioni i Pejës: *TV Syri vision; Top Radio.*

Regjioni i Prizrenit: *Radio Besa; TV Besa; Radio Helix.*

Regjioni i Mitrovicës: *TV Mir; TV Most; Radio Kontakt Plus.*

Regjioni i Gjilanit: *Radio Victoria; TV Puls; TV Vali; TV Zoom; TV Tema; TV Men; Radio Energji.*

Rezultatet nga procesi i licencimit afatgjatë

Procesi i licencimit afatgjatë ka rezultuar me informata të cilat KPM i ka shfrytëzuar për të azhurnuar bazën e të dhënave për të gjitha subjektet transmetuese të licencuara dhe për të përmirësuar mangësi të shumta të procesit të dhënies së licencave të përkohshme gjatë periudhës 2000-2005.

Këto janë të arritura kryesore të procesit të licencimit afatgjatë :

1. Pakoja e licencës afatgjate është harmonizuar në bazë të direktivave të Këshillit Evropian dhe në bazë të praktikave më të mira evropiane si dhe është hartuar në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
2. Është përcaktuar statusi i subjektit transmetues (biznes komercial apo organizatë jo-qeveritare OJQ).
3. Të gjitha licencat afatgjate janë dhënë në bazë të certifikatave të biznesit apo të OJQ-ve të cilat nuk kanë qenë më të vjetra se gjashtë muaj para afatit për aplikim.
4. Është vlerësuar pajtueshmëria e çështjes së pronësisë së subjektit transmetues me Rregulloren e KPM-së për Kualifikimet për marrjen e licencës për transmetim (CIMC 2009/01).
5. Janë rifreskuar të gjitha kontaktet dhe adresat e subjekteve transmetuese.
6. Është krijuar një pasqyrë shumë më e qartë rreth skemës programore për secilin subjekt transmetues në të cilën janë paraqitur në mënyrë të detajuar llojet e programeve. Në këtë mënyrë, janë bërë krahasimet rreth ndryshimeve të mundshme nga licenca e përkohshme në bazë të të cilave kanë operuar subjektet transmetuese.
7. Është krijuar mundësia që pronarët e subjekteve transmetuese të paraqesin kërkesat e tyre për ndryshime të parametrave teknike dhe të zgjerimit të zonës së mbulimit (aty ku ka pas mundësi teknike dhe në pajtim me planin frekuencor të KPM-së).
8. Është krijuar mundësia që pronarët e subjekteve transmetuese të ndryshojnë vendndodhjen e sistemit të transmetimit (aty ku ka pas mundësi teknike dhe në pajtim me planin frekuencor të KPM-së).
9. Subjektet transmetuese kanë instaluar filtrin dalës në transmetues si një prej kushteve kryesore teknike për t'u pajisur me licencë afatgjate. Në këtë mënyrë, KPM ka parandaluar ndërhyrjet e mundshme të sinjalit në mes të subjekteve transmetuese dhe ka siguruar që brezi frekuencor është duke u shfrytëzuar në mënyrë shumë më racionale.
10. Është krijuar mundësia që subjektet transmetuese të ndryshojnë kategorinë e transmetimit (p.sh duke kaluar nga transmetimi me fuqi të ulët, në transmetim lokal, që nënkupton zgjerim të zonës së mbulimit).

Pas përmbylljes së afatit për aplikim për licencë afatgjate, është bërë vlerësimi i pjesës së tretë të licencës, respektivisht vlerësimi i pjesës programore të të gjitha aplikacioneve të subjekteve transmetuese. Nga vlerësimet është gjetur se krahasuar me licencat e përkohshme të KPM-së:

- 30 subjekte transmetuese kanë ulje të përqindjes së programit të shërbimit publik;
- 68 subjekte transmetuese kanë ngritje të përqindjes së programit argëtues, ndërsa
- 3 subjekte transmetuese kanë ruajtur përqindjen e njëjtë të programit të shërbimit publik dhe atij argëtues si në licencën e përkohshme të KPM-së.

Të gjeturat nga krahasimi dhe vlerësimi lidhur me burimin e programit dëshmojnë se pjesa më e madhe e subjekteve transmetuese kanë rritje të përqindjes së programeve të prodhimit vetanak.

Lidhur me instalimin e filtrave dalës të transmetuesit, pas përmbylljes së afatit për aplikim për licencë afatgjate, janë organizuar takime me përfaqësuesit teknik të subjekteve transmetuese me ç'rast u janë dhënë sqarime teknike lidhur me instalimin dhe nevojën e instalimit të këtyre filtrave. Gjithashtu, nga Divizioni për Menaxhim Frekuencor i KPM-së janë bërë vizita të vazhdueshme në terren me qëllim të verifikimit të instalimit të këtyre filtrave nga subjektet transmetuese dhe janë bërë matje të sinjalit pas instalimit të filtrit dalës.

Nga vizitat në terren, me rastin e kontrollimeve teknike të pikave transmetuese nacionale është vërejtur se televizioni publik RTK nuk posedon pjesë rezervë në pikën nacionale Vreshta, që në rast dëmtimit të transmetuesit i tërë regjioni i Prishtinës dhe më gjerë do të mbeteshin të pambuluar me sinjal të RTK-së.

Për kërkesat për ndryshim të lokacionit të transmetuesit, rritjes së fuqisë transmetuese, rritjes së zonës së mbulueshmërisë si dhe kërkesa tjera teknike janë bërë analiza të detajuara sipas kërkesave të tyre, dhe në bazë të të cilave u janë ofruar tabelat teknike, gjegjësisht hartat digjitale e për zonën e mbulimit të licencës. Ndërsa për subjektet transmetuese që kanë kërkesa për zgjerim të sinjalit mbetet që të bëhen analiza shtesë teknike dhe të gjinden zgjidhje adekuate të pranueshme.

2) Zbatimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht

KPM-ja do të bashkëpunojë dhe japë kontributin e saj në nismën e Komisionit Parlamentar për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, për rishikimin dhe amendamentimin e ligjit ekzistues për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim në përputhje me direktivën 2007/65/EC të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës të datës 11 dhjetor 2007.

Punëtorja për amendamentim të Ligjit të KPM-së

Me iniciativë të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media (KSHPALM) dhe në mbështetje të IREX-it, në Ohër të Maqedonisë prej 4 deri më 6 shkurt 2009, është organizuar një takim pune i KPM-së me tri komisionet parlamentare, Komisionin për Shërbime Publike Administratë Lokale dhe Media, Komisionin Parlamentar për Legjislacion dhe Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa, ku është diskutuar për ndryshimet që duhet të bëhen në Ligjin e KPM-së. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të mediave.

Përfaqësuesit e KPM-së kanë dhënë kontributin e tyre duke paraqitur mangësitë që ka ky Ligj dhe problemet që paraqiten në zbatimin e tij në praktikë dhe duke dhënë propozime për përmirësimin e Ligjit, në harmoni me standardet Evropiane.

Gjithashtu, KPM ka përcjell të gjitha takimet e Komisionit Parlamentar për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, gjatë amendamentimit të Ligjit të KPM-së dhe ka bashkëpunuar

ngushtë me këtë Komision duke u përgjigjur në të gjitha kërkesat për sqarimet e nevojshme të cilat janë kërkuar nga Komisioni gjatë amandamentimit të Ligjit të KPM-së.

KPM konsideron se nisma për amandamentimin e Ligjit Nr.02/L-15, për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetim, i aprovuar në prill të vitit 2005, ishte e qëlluar për faktin se disa dispozita të tij nuk janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, shkaktojnë probleme gjatë zbatimit si dhe për faktin se Ligji përmban edhe gabime terminologjike, teknike, strukturore dhe gjuhësore.

3) Krijimi dhe adoptimi i politikës për procesin e digjitalizimit

Kompletimi i hartimit të strategjisë për digjitalizim.

Për vitin 2009, KPM pati përcaktuar për objektive krijimin dhe adoptimin e politikës për procesin e digjitalizimit. Kjo objektive është arritur vetëm deri në atë masë sa është caktuar një bazë mbi të cilën mbështetet planveprimi për strategjinë.

Fillimisht, është iniciuar analizimi i rezultateve për Kosovën të dala nga Konferenca rajonale Gjeneva 2006, kur janë bërë ndarjet frekuencore digjitale televizive dhe në të cilën konferencë nuk ka patur përfaqësues nga Kosova². Për këtë qëllim, në shtator 2009 KPM ka angazhuar dy ekspertë për planifikim frekuencor që të bëjnë këtë punë të domosdoshme: të analizojnë planin frekuencor (allotmentin e Kosovës), në aspektin teknik, të ndarë për Kosovën nga ITU dhe përfaqësuesit nga Serbia dhe të propozojnë një plan alternativ. Ky projekt i KPM-së është bashkëfinancuar nga IREX.

Një analizë e tillë ka qenë e nevojshme për të filluar tërë punën për vet hartimin e strategjisë. Ka qenë e nevojshme që të kuptohet se si do të reflektohet zbatimi i këtij plani në Kosovë dhe sa do të përmbusheshin nevojat e Kosovës (duke konsideruar mbulueshmërinë dhe numrin e frekuencave). Pavarësisht rezultateve teknike të detajuara për planin, KPM ka synuar qysh në fillim që të ketë një plan alternativ për faktin që ai plan i rezultuar nga Gjeneva 2006 nuk është negociuar nga Kosova, por nga një administratë tjetër. Plani i propozuar alternativ është punuar sipas parimeve të përcaktuara nga ITU, plan që në aspektin ligjor dhe teknik nënkupton modifikim të planit të vitit 2006. Bazuar në nenin 4 të Akteve Finale të Marrëveshjes Gjeneva 2006 modifikimi lejohet.

Hapi i dytë në këtë drejtim është bërë me organizimin e konferencës rajonale më 4 dhe 5 dhjetor 2009: ***“Prezantimi i transmetimit digjital në Kosovë dhe Regjion - STRATEGJITË³”***.

Afati i fundit për ndërprerjen e transmetimit analog dhe kalimin në transmetim digjital në vendet jo anëtare të Bashkimit Evropian është viti 2015. Për shkak të mos anëtarësimit të Republikës së Kosovës në ITU, procesi drejt digjitalizimit kërkon angazhim më të madh në Kosovë në krahasim me vendet tjera anëtare të ITU-së. Kështu që organizimi i konferencës dhe sjellja e përvojës rajonale është një prej hapave të parë drejt përgatitjes për digjitalizimin. Përfaqësuesit e rregullatorëve nga Shqipëria, Mali i zi, Maqedonia, Kroacia, Sllovenia dhe Bosnja e Hercegovina kanë prezantuar përvojat e tyre rreth përgatitjeve dhe hapave të ndërmarrë për transmetimin digjital në vendet e tyre. Edhe pse të gjitha këto shtete kanë qenë në përparësi si në aspektin politik dhe financiar kanë hasur në vështirësi në përgatitjet për kalim në sistemin digjital.

Qëllimi tjetër i kësaj konference ishte edhe prezantimi i planit frekuencor digjital i cili është hartuar nga dy ekspert të angazhuar nga KPM. Ky është një plan alternativ i cili pretendon t'i plotësojë nevojat e transmetimit digjital në Republikën e Kosovës.

² Raporti i ekspertëve për këtë analizë frekuencore është paraqit në shtojcën III të këtij raporti.

³ Konkluzat nga kjo konferencë janë përmbledhur në një raport të veçantë i cili është dhënë në shtojcën IV në këtij raport.

KPM ka themeluar grupet punuese të para si vazhdimësi e punës drejt realizimit të kësaj objektivë:

- grupi punues për informim;
- grupi për çështje të përmbajtjes së programeve;
- grupi punues për çështje teknike;
- grupi punues për çështje ligjore; dhe
- grupi punues për çështje shoqërore-ekonomike.

Këto grupe punuese gjatë vitit 2010 do të zgjerohen me angazhimin e përfaqësuesve nga institucionet tjera kosovare, mediat dhe shoqëria civile. Për mbarëvajtjen e punëve të këtyre grupeve punuese, KPM do të angazhojë një sekretari e cila do të jetë koordinuese e punëve të pesë grupeve.

Pas konferencës ndërkombëtare e cila mediave kosovare dhe palëve tjera me interes ju përcolli përvojën e 6 shteteve të regjionit, përfaqësues të KPM-së për herë të parë u takuan me përfaqësues të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimit gjatë një vizite studimore në Gjenevë të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Kjo vizitë kishte për qëllim krijimin e kontakteve të para në nivelin rregullator- ITU. Përfaqësuesve të ITU-së nga Zyra për Radiokomunikime dhe nga Zyra për Zhvillim të Rrjeteve u janë prezantuar gjetjet nga analiza e planeve të ndara në Konferencën Gjeneva 2006, respektivisht gjetjet e allotmentit të Kosovës i cili në planin aktual ekziston si një prej allotmenteve të Republikës së Serbisë. Është diskutuar për shkaqet pse ai plan nuk është i pranueshëm dhe është kërkuar që të konsiderohet Kosova si një vend i cili ka nevojë për një koordinim për një plan të modifikuar, pos koordinimit me shtetet fqinjë. Zyrtarët e ITU-së, edhe pse kanë qenë shumë korrekt kanë qartësuar që veprimet e ITU-së në relacion me Kosovën janë të kufizuara për shkak të mos anëtarësimit të Kosovës në ITU.

4) Promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese

Rishikimi dhe amandamentimi i Rregullës për Reklamim

Në fillim të vitit 2009, Këshilli i KPM-së ka shqyrtuar Rregullën për Reklamim për Subjektet Transmetuese CIMC – 2007/06 të miratuar në vitin 2007. Ky rishikim është bërë në të njëjtën kohë kur Këshilli, sipas obligimit ligjor të dhënë me Ligjin për Radio Televizionion e Kosovës, ka shqyrtuar edhe reklamën në subjektin transmetues publik. Pas analizës së bërë u konkludua që Rregulla CIMC 2007/0 kishte mangësi strukturore dhe teknike që nuk përkonin më me ndryshimet e bëra në fushën e transmetimit. Po ashtu, u vendos që me këtë amandamentim të përcaktoheshin edhe kufizimet kohore të reklamës në transmetuesin publik, gjë që duhej të ndodhte qysh në vitin 2007, por për shkak të paralajmërimeve të ndërprerjes së kontratës për inkasimin e taksës publike e cila STP i siguron pjesën më të madhe të buxhetit, Këshilli i KPM-së nuk kishte ndërmarrë një vendim të atillë me qëllim që të mos dëmtohej funksionimi i transmetuesit të vetëm publik.

Vendimin për ndryshim Këshilli i KPM-së e mori në takimin e datës 12 shkurt ndërsa në seancën e vet të mbajtur më datën 14 prill 2009, shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi punues i Zyrës së KPM-së, me ç'rast paraqiti disa sugjerime dhe plotësime dhe vendosi që Draftin e Plotësuar ta vë në Diskutim Publik duke filluar prej datës 17 prill deri më 4 maj 2009.

Këshilli i KPM-së, më datën 28 maj 2009, mbajti një debat publik për Rregulloren e re për Komunikimet Komerciale Audiovizuale (KKPM 2009/04), ku ishin të ftuara të gjitha Mediat Elektronike të Licencuara nga KPM, me ç'rast shumë prej tyre paraqitën komentet dhe sugjerimet e tyre. Para miratimit të Rregullores, Këshilli i KPM-së është takuar disa herë edhe me menaxhmentin e RTK-së për të shkëmbyer informacionet e nevojshme që do të merreshin në konsideratë për kufizimet e reklamës në RTK.

Më 28 gusht 2009 Këshilli aprovoi Rregulloren KKPM 2009/04, e cila përcaktohej të hynte në fuqi tre muaj pas aprovimit.

5) Licencimi i operatorëve kabllor në Veriun e Kosovës

KPM, me ndihmën e OSBE-së, ka arritur të krijojë një rrugë komunikimi me operatorët kabllorë që vepronë ilegalisht në pjesën veriore të Kosovës. Zyrtarët e KPM-së janë takuar dy herë me përfaqësuesit e operatorëve kabllor serb dhe në të dy takimet iu janë dorëzuar dokumentacionet e nevojshme për të aplikuar për licencë të KPM-së për të operuar ligjërisht me shërbime televizive kabllore. Pavarësisht atyre takimeve dhe përpjekjeve tjera, asnjë nga operatorët kabllor serb që operojnë ilegalisht në pjesën veriore nuk ka aplikuar për licencë të KPM-së. KPM ka arritur të identifikojë se në pjesën veriore të Republikës së Kosovës vepronë ilegalisht dy operator kabllor: 1. Operatori Kabllor “LINK” dhe 2. Operatori Kabllor “VGN”.

Rrethanat politike të krijuara në pjesën veriore të Republikës së Kosovës dhe shkaqet e sigurisë, kanë qenë pengesë kryesore për KPM që të vë legjislacionin mbi operatorët kabllorë që vepronë ilegalisht në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

Angazhimi i KPM për vitin 2010, mbetet një prej prioriteteve për të proceduar me licencimin e operatorëve ilegal kabllor që operojnë në pjesën veriore të Republikës së Kosovës mirëpo aktiviteti i KPM-së për të ushtruar autoritetin e vet në këtë drejtim lidhet shumë ngushtë edhe me zhvillimet politike në këtë pjesë të Kosovës.

Gjatë vitit 2009 KPM ka marrë vendim që të hap një zyrë në Mitrovicë (veri) që të ngrisë qasjen e operatorëve të minoritetit serb në punën e KPM-së.

6) Krijimi i parakushteve për përmbushjen e obligimit kushtetues për krijimin e një transmetuesi nacional në gjuhën serbe

KPM ka bashkëpunuar ngushtë me Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO), UNDP, Kuvendin e Kosovës, OSBE-në në hapjen e debatit për transmetimit nacional në gjuhën serbe. KPM gjithashtu ka paraqitur me shkrim optionet e mundshme, me përparësitë dhe mangësitë e themelimit të kanalit nacional në gjuhën serbe.

KPM do të punojë me institucionet relevante kosovare dhe me komunitetin e medias serbe që të bëhet një planveprim për realizimin e kësaj kërkesë.

7) Përforcimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane

Organizimi i konferencës EPRA 2010 në Kosovë:

Nga Bordi i EPRA-s është vendosur që të bëhen ndryshime për oraret e mbajtjes së konferencave të ardhshme dhe kjo ka ndikuar që të ketë shtyerje të Konferencës së paraparë të mbahet në Kosovë. Sidoqoftë, falë bashkëpunimit përmes kësaj platforme me autoritetet tjera, në konferencën e KPM-së për digjitalizim kanë kontribuar pikërisht anëtarët e kësaj platforme me pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2010

1. PËRCAKTIMI I POLITIKËS SË KALIMIT NË PLATFORMË DIGJITALE TË MEDIAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS

- HARTIMI I STRATEGJISË PËR DIGJITALIZIM - Koordinimi i brendshëm dhe i jashtëm përmes punës së grupeve punuese dhe përfshirjes së institucioneve relevante kosovare (koordinim të planit frekuencor me shtetet fqinjë, fillimin e negociatave për anëtarësim në ITU). Këto koordinime do të realizohen përmes debateve, seminareve dhe konferencave të ndryshme të cilat do të plotësojnë edhe punën e grupeve punuese). KPM do të jetë udhëheqëse e procesit.

2. ZHVILLIMI I TREGUT MEDIAL QË U SHËRBEN TË GJITHË QYTETARËVE TË KOSOVËS

- LËSHIMI I LICENCAVE TË REJA- Pas përfundimit të procesit të licencimit afatgjatë do të bëhet rishikimi i planit frekuencor analog për të mundësuar lëshimin e licencave të reja me qëllim të ofrimit të qasjes në media në ato vende ku ekziston nevojë për sinjal radio-televiziv.
- PËRMBUSHJA E OBLIGIMIT KUSHTETUES PËR KRIJIMIN E NJË TRANSMETUESI NACIONAL NË GJUHËN SERBE - KPM-ja do të bashkëpunojë me akterët tjerë dhe do të japë kontributin e saj si anëtare e Grupit Drejtues për themelimin e kanalit televiziv në gjuhën serbe në nivel të Kosovës.
- LICENCIMI I OPERATORËVE KABLLORË NË VERIUN E KOSOVËS - Ky do të jetë një angazhim i vazhdueshëm i KPM-së për vitin 2010.

3. PROMOVIMI I KONKURENCËS SË DREJTË TRANSMETUESE

- ZBATIMI I RREGULLËS PËR REKLAMIM - Rregullorja ka hyrë në fuqi me 1 janar 2010 dhe KPM-ja do të monitorojë me kujdes zbatimin e drejtë të saj .

4. ZHVILLIMI I POLITIKAVE TË TRANSMETIMIT NË PËRPTHJE ME STANDARDET E PRANUARA NDËRKOMBËTARISHT

- RISHIKIMI DHE PLOTËSIMI I LEGJISLACIONIT SEKONДАР - Që nga fundi i vitit 2006 kur edhe është themeluar Komisioni i Pavarur për Media, me funksionalizimin e organit vendimmarrës-Këshillit, KPM ka punuar në krijimin e infrastrukturës ligjore për veprimtarinë transmetuese në Kosovë. Pas 3 vitesh funksionimi skena mediale ka ndryshuar dukshëm dhe ka lind nevoja që në përgjithësi të bëhet një rishikim i akteve nënligjore ekzistuese. Kështuqë, gjatë vitit 2010 KPM do të rishikojë dhe amandamentojë Kodin e sjelljes për shërbimet mediale audiovizuale, Rregulloren për ritransmetimin e kanaleve radiotelevizive në rrjetin kabllor dhe Vendimin për taksën për licencë.

Kodi etik– mediat ende veprojnë në pajtim me Kodin e nxjerrë në vitin 2000, i cili bazohet në parimet e pranueshme evropiane mirëpo tani paraqitet nevoja që kjo të ndryshojë dhe të plotësohet e të nxirret një kod nga Këshilli i KPM-së.

Rregullorja për operimet në sistemin kabllor – operatorët aktivë kabllorë kanë kaluar në sistem të avancuar digjital. Në relacion me operimet kabllorë, ka ndodh që industria ka ec para se të krijohet baza ligjore për rregullimin e tyre dhe KPM ka arrit që për një kohë të shkurtër t'i vëjë nën kornizën ligjore. Mirëpo, edhe zhvillimi i tyre teknologjik e edhe zhvillimet tjera mediale paraqesin nevojën që kjo kornizë ligjore të plotësohet dhe të ketë ndarje të qarta të sistemeve të transmetimit.

Vendimet për taksën për licencë: në vitin 2007 është nxjerrë vendimi për nivelin, mënyrën dhe përcaktimin e taksës për licencë për operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimeve të programeve ndërsa në vitin 2008 ka nxjerrë vendimin për nivelin,

mënyrën dhe përcaktimin e taksës për licencë për subjektet transmetuese. Me ligjin për KPM, përcaktohet që taksë për licencë duhet të shqyrtohet çdo dy vite dhe varësisht prej rrethanave të krijuara edhe të ndryshohet. Këshilli iKPM-së me qëllim të caktimit të taksës për licencë për të gjitha shërbimet mediale audiovizuale (subjekte transmetuese, operatorë kabllorë kabllorë dhe OSHP) përmes një vendimi të vetëm të aplikueshëm për të gjithë.

5. NGRITJA E KAPACITETEVE PËR MONITORIM TË PROGRAMEVE -

Implementimi i projektit IPA 2009, realizimi i të cilit ka filluar nga fundi i vitit 2009, dhe i cili planifikohet të përfundojë deri në fund të vitit 2010, do të mundësojë krijimin e sistemit të monitorimit që mundëson monitorimin e të gjitha subjekteve transmetuese në territorin e Republikës së Kosovës. Përmes këtij sistemi do të sigurohet ngritja e kapaciteteve monitoruese të KPM-së për Vlerësimin e cilësisë programore të subjekteve transmetuese; Pajtueshmërinë e subjekteve transmetuese me të drejtën e autorit;Pajtueshmërinë me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore;Pajtueshmërinë me Rregulloren për Komunikime Komeriale Audio-vizuale; dhe Kushtet e Termet e Përgjithshme të Licencës. Implementimi i këtij projekti mundëson monitorim efikas dhe të detajuar, si dhe krijon mundësi për analizim dhe vlerësim të programeve të transmetuara, përmes të cilit KPM krijon një pasqyrë të qartë rreth llojeve të programeve. Ky sistem mundëson incizimin dhe arkivimin e programeve të transmetuara 24 orë në ditë për 45 ditë.

PREZANTIM I PUNËS SË KËSHILLIT TË KPM-së

Përbërja dhe Nominimet

Si rezultat i mbarimit të mandateve dy vjeçare (sipas Ligjit të KPM), Këshilli i KPM-së gjatë vitit 2009 ka funksionuar me përbërje jo të plotë, për faktin se që nga data 28 gusht 2008 nuk është emëruar anëtar i shtatë (7) që nominohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Këshilli i KPM-së ka funksionuar në përbërje prej gjashtë (6) anëtareve të nominuar nga shoqëria civile, kryesuar nga Argjentina Grazhdani e rizgjedhur për Kryetare edhe për një mandat nga Këshilli i KPM-së më 6 prill 2009.

Dy anëtarëve të Këshillit të KPM-së ju përfundon mandati më 14 mars 2010. Zyra e Shefit Ekzekutiv në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së për procedurën e nominimeve dhe emërimeve të reja, në vitin 2009 filloi procesin e nominimeve. Ftesa publike për nominime është bërë më 25 nëntor dhe ka përfunduar më 9 dhjetor 2009. Në mungesë të nominimeve të mjaftueshme për anëtarë të Këshillit të KPM-së, dhe në mënyrë që të sillet në pajtueshmëri me kërkesat ligjore që Këshilli të reflektojë shoqërinë multietnike në Kosovë, Zyra e Shefit Ekzekutiv ka vazhduar afatin edhe për dy javë (prej 11 deri më 28 dhjetor 2009).

Në afatet e publikuara u pranuan gjithsej tetë (8) nominime, të cilat u publikuan dhe u dërguan për komente publike sipas procedurave ligjore. Zyra e Shefit Ekzekutiv më 29 janar 2010 ka përmbushur obligimin e saj ligjor, kur përfundimisht i dërgoi Kuvendit të Republikës së Kosovës listën me emrat e katër kandidatëve më të kualifikuar për procedim të mëtejshëm.

TAKIMET DHE VENDIMET E KËSHILLIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA GJATË VITIT 2009

Këshilli i KPM-së, gjatë vitit 2009, ka mbajtur katërmbëdhjetë (14) takime. Këshilli i KPM-së ka miratuar Pakon e Licencimit Afatgjatë si dhe Planin e rishikuar frekuencor. Në këtë mënyrë Këshilli i KPM-së ka filluar procesin e licencimit afatgjatë.

Këshilli i KPM-së në vitin 2009 ka miratuar 4 rregullore, ka marrë vendime për lëshimin e licencave afatgjate për 80 subjekteve transmetuese, 15 Ofrues të Shërbimeve Programore dhe një operator kabllor. Këshilli gjithashtu ka nxjerr 9 vendime sanksionuese për subjektet transmetuese të cilat janë gjetur në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

Rregulloret e miratuara nga Këshilli i KPM-së

1. Rregullorja CIMC 2009/01 për subjektet transmetuese për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore⁴ - ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental, emocional dhe moral.

Gjithashtu kjo rregullore përcakton mënyrën e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve.

2. Rregullorja CIMC 2009-02 mbi kualifikimet për dhënien e licencës së KPM-së për transmetim⁵ - përcakton kriteret që kërkohen të plotësohen nga kandidatët për licencë të

⁴ Shtojca VI e raportit

⁵ Shtojca VII e raportit

KPM-së. Sipas kësaj rregulloreje bëhet vlerësimi i kërkesave të paraqitura për dhënien e licencës së KPM-së ku do të zbatohen kriteret e parapara me nenin 12.4 të Ligjit të KPM-së si dhe kritere shtesë të përcaktuara nga Këshilli i KPM-së me rastin e shpalljeve publike për frekuenca të reja.

3. Rregullorja CIMC 2009/03 për pajtueshmërinë me obligimet e të drejtës së autorit⁶ - parasheh respektimin e të drejtës dhe praktikës ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e pronës intelektuale duke përfshirë, por jo kufizuar në, audio dhe video materiale argëtuese është vendimtarë për zhvillimin e konkurrencës së rregullt dhe të drejtës në tregun medial. Një treg medial, i rregulluar në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira, është thelbësore për zhvillimin e një ekonomie të tregut në Kosovë. (*Rregulloret CIMC 2009/02 dhe 2009/03 janë miratuar si pjesë përbërëse e pakos për licencim afatgjatë*)

4. Rregullorja KKPM 2009/04 për komunikimet komerciale audiovizuale⁷ - përcakton parimet themelore të komunikimit komercial audiovizual, teleshopingut dhe sponsorimit për transmetimin e tyre në ofruesit e shërbimeve mediale. Kjo rregullore nuk trajton çështjet e ndërlidhura me komunikimin komercial audiovizual politik, i cili është i rregulluar me ligje dhe rregullore përkatëse. Kjo rregullore gjithashtu përcakton përmbajtjen e komunikimit komercial audiovizual dhe çështjet etike të komunikimi komercial audiovizual në të gjithë ofruesit e shërbimit medial. Kjo rregullore përcakton edhe sasinë e komunikimit komercial audiovizual të transmetuar nga shërbyesit audiovizual duke përfshirë edhe teleshopingun.

ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE

Një praktikë tashmë e dëshmuar e bashkëpunimit dhe transparencës së Komisionit të Pavarur për Media është edhe mbajtja e takimeve publike me qëllim të ofrimit të mundësisë për komente dhe propozime nga mediat dhe palët tjera me interes. Ky proces zakonisht është zhvilluar para miratimit të akteve të veçanta nënligjore të cilat bazohen në Ligjin për KPM-në, respektivisht nenin 3.2.

Më 3 prill 2009 KPM ka mbajtur takim publik me subjektet transmetuese të licencuara në Kosovë, në të cilin u diskutua mbi Draft Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore, nga i cili takim u diskutua dhe u komentua draft rregullorja në fjalë e cila pastaj inkorporoj në vete komentet e vlefshme për tu miratuar pastaj.

Në kuadër të procesit të licencimit afatgjatë KPM më 28 maj 2009 ka organizuar takim publik me subjektet transmetuese të licencuara në Kosovë, në të cilin u diskutua për Draft Pakon e Licencimit Afatgjatë dhe Draft Rregullën për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

Me përkrahje të OSBE dhe me qëllim të përgatitjeve për monitorim të mediave gjatë fushatës zgjedhore më 2 dhe 3 tetor 2009, KPM ka organizuar takim pune në të cilën janë rishikuar dhe amandamentuar tre Udhëzuesit për Media për respektim të dispozitave ligjore për mbulim të fushatës zgjedhore. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga Komisioni Parlamentar për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Pas takimit të punës, KPM organizoi Konferencën “Mediat dhe Zgjedhjet” më 13 tetor 2009, në të cilën subjekteve transmetuese dhe ofruesve të shërbimeve programore iu prezantuan tre (3) Udhëzuesit e KPM-së të cilët do të respektoheshin nga subjektet transmetuese të licencuara në KPM-në gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve lokale 2009 në Kosovë:

- I. Udhëzuesi për identifikimin e reklamimit politik,
- II. Udhëzuesi për raportimin e hulumtimit të opinionit publik lidhur me zgjedhjet dhe
- II. Udhëzuesi për periudhën e heshtjes së mediave.

⁶ Shtojca VIII e raportit

⁷ Shtojca 9 e raportit

KONFERENCAT

Komisioni i Pavarur për Media në bashkëpunim me Këshillin e Mediave të Shkruara, më 28 dhe 29 tetor 2009, në mbështetje të OSBE-së, ka mbajtur konferencën e përbashkët dyditore për vetëdijesimin e opinionit publik lidhur me rolin e këtyre dy institucioneve dhe për Marrëdhëniet media-polici-sistem i drejtësisë. Në mungesë të një kornize ligjore që përcakton shërbimet që duhet të ofrojnë mediat ndaj kërkesave të këtyre organeve, kohë pas kohe po paraqiten probleme, sidomos kur mediat me kërkesa individuale dhe të pabazuara ligjërisht obligohen që të ofrojnë materiale dhe incizime nga ngjarje të ndryshme dhe kërkesat nuk bëhen vetëm për materialet e transmetuara por edhe për ato të paedituara të cilat mediat nuk kanë obligim t'i mbajnë. Sidomos referimi në legjislacion të KSAK-ut e bën këtë situatë edhe më konfuze andaj KPM e ka parë si shumë të rëndësishme që të debatohet për këtë së bashku me institucionet relevante, përfaqësuesit e të cilave kanë konkluduar se KPM dhe KMSH mund të ndikojnë në përmirësimin e marrëdhënieve në relacion media-drejtësi-polici.

Më 4 dhe 5 dhjetor 2009, KPM organizoi konferencën ndërkombëtare me temën “Prezantimi i transmetimit digjital në Kosovë dhe Rajon - STRATEGJITË”, e cila është raportuar më lartë, tek realizimi i objektivës Nr.3 për vitin 2009.

RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS - ZHVILLIMET NË 2009

Emërimi i Bordit

Pas themelimit të Komisionit të Pavarur për Media në muajin gusht të vitit 2006, Këshilli i KPM-së i përcaktoi vetes detyrë me prioritet që të angazhohet për të siguruar emërimin e Bordit të RTK-së. Sipas Ligjit për RTK-në i cili u shpall në vitin 2006, Këshillit të KPM-së i caktohet të inicojë procesin dhe poashtu të jetë pjesë e procesit me pjesëmarrje në Komisionin Ad Hoc përzgjedhës të kandidatëve. Kështuqë, në shkurt 2007 Këshilli i KPM-së mblodhi komisionin ad hoc dhe bëri ftesën për nominime. Në qershor 2007, Komisioni Ad Hoc përcolli në Kuvend 18 emrat e të nominuarve që ishin përzgjedhur, mirëpo procedimi i tyre me emërim nuk u bë dhe në maj të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkoi nga KPM që të fillojë një proces të ri të nominimeve. Procesi i vitit 2008 përfundoi në muajin tetor ku u përcollën 18 emra të rinj për t'u emëruar në Bordin e RTK-së, mirëpo këto nominime nuk u proceduan deri në emërim. Në korrik të vitit 2009, Komisioni Ad Hoc i Kuvendit të Republikës së Kosovës kërkoi nga KPM që të shpallet sërish konkursi për nominime të reja për Bordin e Radio Televizionit të Kosovës, i treti me radhë.

Komisioni i Pavarur për Media më 31 korrik 2009 publikoi ftesën për nominime të reja, dhe mandej me kërkesë të Komisionit Ad Hoc ri-shpalli konkursin me 26 gusht 2009, pasi që nga Komisioni u konstatua që gjatë konkursit të parë nuk kishte nominime të mjaftueshme që plotësojnë kushtet e parapara me ligj dhe të përfaqësuesve të minoriteteve.

Më 28 shtator 2009, Komisioni Ad-Hoc në përbërje të Akademik Mehmet Kraja, znj. Vjosa Dobruna, znj. Snezhana Karaxhiq, dhe z. Milazim Krasniqi nga Bordi i RTK-së, z. Agim Sopi, znj. Filloreta Bytyçi dhe z. Ramë Bajraktari nga Këshilli i KPM-së, ka bërë përzgjedhjen e 18 të nominuarve për anëtarë të Bordit të ri të Radio Televizionit të Kosovës. Lista i është përcjellë Kuvendit të Republikës së Kosovës për të proceduar tutje deri në zgjedhjen e nëntë (9) anëtarëve për Bordin e RTK-së. Bordi i ri i Radio Televizionit të Kosovës përfundimisht është emëruar nga Kuvendi i Kosovës në tetor 2009.

Financimi i RTK-së

Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi në tetor 2009 të suspendojë inkasimin e taksës publike për financim të RTK-së përmes faturave të energjisë elektrike dhe në fund të muajit nëntor KEK ndërpreu kontratën me RTK për inkasimin e kësaj takse. Sidoqoftë, KEK nuk inkasoi 3.5 Euro që nga muaji tetor, duke respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

KPM ka bashkëpunuar ngushtë me RTK-në për gjetjen e një zgjidhje afatshkurtër dhe afatgjatë të financimit të RTK-së, dhe në nëntor 2009 është përcjellur në Kuvend rekomandimi i përbashkët i Këshillit të KPM-së dhe Bordit të RTK-së me propozimet për formulimet ligjore që sigurojnë financimin afatgjatë.

Në gusht 2009, Këshilli i KPM-së ka miratuar Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale me të cilin kufizohet koha e reklamimit në RTK. Pas zhvillimeve që pasuan me Gjykatën Kushtetuese dhe Korporatën Energjetike të Kosovës, RTK kërkoi nga Këshilli i KPM-së që implementimi i Rregullores të shtyhej. Më 18 nëntor 2009, Këshilli i KPM-së informoi Bordin dhe Menaxhmentin e RTK-së, e poashtu edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, që ka vendosur të shtyjej zbatimin e Rregullores deri më 1 janar 2010. Në këtë njoftim Këshilli sugjeroi që të ketë angazhim të Kuvendit si themelues, dhe palëve të tjera, për të bërë zgjidhje të financimit afatgjatë.

KPM, para miratimit të rregullores ka analizuar zhvillimin e RTK-së në aspektin financiar duke krahasuar përfshirjen e reklamës brenda buxhetit të përgjithshëm. Të hyrat nga reklamimi, në buxhetin e përgjithshëm vjetor të RTK-së janë zvogëluar gradualisht prej vitit në vit me rritjen e të hyrave nga inkasimi i taksës publike, kështuqë përderisa në vitin 2002 reklamat përbënin 24.27% të buxhetit të përgjithshëm, në vitin 2008 të hyrat nga reklama kanë përbërë 14.37% të të hyrave . KPM ka bërë edhe monitorime për sasinë e reklamës së transmetuar në RTK. Rezultatet nga monitorimet janë llogaritur dhe krahasuar me të dhënat e ofruara nga RTK për mesataren e çmimit për një sekondë të reklamës në RTK gjatë vitit 2008 dhe poashtu edhe për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2009. Me këto analiza është konstatuar se kufizimet e reklamës me rregulloren e re nuk dëmtojnë veprimtarinë e RTK-së.

RTK rrezikohet vetëm me heqjen e burimit të financimit afatgjatë, financimit nga taksa publike dhe KPM është e përkushtuar që të angazhohet maksimalisht për gjetjen e një rrugëzgjidhje në mënyrë që transmetuesi publik të veprojë në dobi të shikuesve kosovarë si i tillë, i pavarur financiarisht dhe me program kualitativ.

PREZANTIM I PUNËS SË ZYRËS SË SHEFIT EKZEKUTIV

Në fillim të vitit 2009 Zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së ka operuar me një staf prej 21 shërbyesish civilë, ndërsa deri në fund të vitit numri i të punësuarve ka arritur në 28. Gjatë vitit 2009 janë publikuar 6 shpallje dhe 4 rishpallje për vende të lira të punës (1 shpallje për Menaxher të Teknologjisë Informative, 2 shpallje për Menaxher për Monitorim Regjional, 1 shpallje për Auditor të brendshëm, 1 shpallje për Asistent Ekzekutiv, dhe 1 shpallje për Zyrtar Ligjor, 1 rishpallje për Asistent Ekzekutiv dhe 3 rishpallje për Auditor të brendshëm).

Vështirësitë me të cilat është ballafaquar Zyra e Shefit Ekzekutiv në vitet paraprake, janë tejkaluar dukshëm dhe situata e pozitës së personelit është përmirësuar me fuqizimin e rishikimit funksional, respektivisht me nivelizimin e pagave, i cili është mundësuar me angazhimin e komisioneve funksionale parlamentare (Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Media). Rishikimi funksional është bërë me qëllim të organizimit, ndarjes së drejtë të përgjegjësisë, riorganizimit dhe përmirësimit të pagave për personelin e Zyrës së Shefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media.

Departamenti i Administratës të Shërbimit Civil (DASHC/MAP) ka shqyrtuar Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës të datës 18.11.2009, lidhur me kërkesën (ref.0911/2026/EXD/nsk) e Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim, për implementimin e rishikimit funksional dhe nivelizimit të pagave të stafit brenda KPM-së duke u bazuar në rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa (nr.03/2176/Do-1349 të datës 15.5.2009 dhe nr.03/2384/Do-1491 të datës 18.6.2009 MAP/DASHC), ka bërë procedimin në sistemin e pagave të koeficientëve të përkohshëm të pagave për stafin e KPM-së deri sa të aprovohet Ligji për Pagat në Administratën Publike.

DIVIZIONI I MONITORIMIT

Ngritja e kapaciteteve (teknike dhe njerëzore)

Në vazhden e përpjekjeve që Zyra e KPM-së po i bënë për avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të saj, në janar të vitit 2009 ka organizuar një trajnim të stafit monitorues lidhur me monitorimin e përmbajtjeve programore të mediave elektronike. Ligjëruese në këtë trajnim ishte Profesoresha e Komunikimeve Strategjike në Universitetin e Oklahomas dhe eksperte për hulumtim, dr. Maureen Taylor. Gjatë trajnimit janë përcaktuar kriteret në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i performancës së tyre. Trajnimi është mbështetur nga IREX.

Gjatë vitit 2009, Divizioni i Monitorimit të KPM-së është pajisur me automjet me pajisje digjitale për monitorim përmbajtësor të subjekteve transmetuese, projekt kapital i financuar nga Buxheti i Kosovës. Automjeti posedon pajisje digjitale për monitorim në terren (me të gjitha pajisjet harduerike dhe softuerike), antena për pranimin e sinjalit, serverët me lidhje të VPN (Virtual Private Netëork) dhe rrjetë, si dhe me hapësirë të mjaftueshme për punë.

Projekti ka përfshirë edhe trajnimet për punën me pajisjet e instaluar në veturë dhe mirëmbajtjen e tyre si dhe server-in ku do të ruhen të gjitha regjistrimet e programeve të subjekteve transmetuese të bëra në terren. Trajnimi i parë për punën me këto pajisje është kryer në Zyrën e KPM-së, ndërsa trajnimi i avancuar do të mbahet gjatë vitit 2010 me kompaninë e cila ka realizuar projektin. Realizimi i këtij projekti ka mundësuar monitorimin mobil të mbulimit të fushatës zgjedhore nga subjektet transmetuese.

Nga fundi i vitit 2009, ka filluar edhe realizimi i Projektit të Monitorimit Statik projekt i bashkë-financuar nga Instrumenti i Para Anëtarësimit (IPA 2009) në vlerë prej 1,000,000.00 (një milion)

Euro dhe Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 100,000.00 (një qind mijë) Euro. Sipas projektit ky sistem monitorimi planifikohet të ndërtohet në gjashtë (6) qendra të Republikës së Kosovës, ku do të mblihdhen të dhënat për të gjitha programet e transmetuara brenda 24 orësh, të cilat pastaj do të arkivohen në qendrën kryesore në Prishtinë. Projekti do të realizohet gjatë vitit 2010.

Monitorimet

Viti 2009 karakterizohet me aktivitete të dendura të Divizionit të Monitorimit dhe Pajtueshmërisë së Mediave. Këto aktivitete i kanë paraprirë përgatitjeve për fillimin e procesit të licencimit afatgjatë, pasi që Komisioni i Pavarur për Media ka shpallur vitin 2009 vit të licencimit afatgjatë të mediave elektronike në Kosovë. Projektet e realizuara gjatë këtij viti lidhur me monitorimin e pajtueshmërinë së subjekteve transmetuese me Kushtet dhe Termet e licencës si dhe me Rregulloret e KPM kanë dëshmuar se shumë subjekte transmetuese tashmë veprojnë në pajtueshmëri me këto Rregullore.

Pas realizimit të një projekti lidhur me pajtueshmërinë me të drejtën e autorit (realizimi i të cilit ka filluar nga fundi i vitit 2008 dhe ka përfunduar në shkurt të vitit 2009) gjatë të cilit është bërë monitorimi i të gjitha televizioneve lokale, është gjetur se shumë nga subjektet transmetuese kanë filluar të pajisen me marrëveshje për të drejtën e autorit, që dëshmon për efektin pozitiv të monitorimeve dhe rekomandimeve të bëra për të vepruar në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Licencës – kapitulli mbi të drejtat e autorit. Monitorime të pajtueshmërisë me të drejtën e autorit kanë vazhduar përgjatë tërë vitit 2009, kur në fokus të këtyre monitorimeve janë vënë në rend të parë subjektet transmetuese të cilat në monitorimet paraprake janë gjetur në shkelje të drejtës së autorit. Realizimi i projekteve tjera si: Pajtueshmëria me Rregullën për Reklamim, monitorimi i përmbajtjeve programore, pajtueshmëria me Kushtet e Termet e Licencës së KPM-së, i mundësoi DMPM-së krijimin e një pasqyre më të saktë për performancën e çdo subjekti transmetues në prag të procesit të licencimit afatgjatë.

Në periudhën raportuese, janë monitoruar edhe operatorët kabllor (OK) të licencuar nga KPM. Poashtu është punuar edhe në identifikimin e OK ilegal, të cilët, pas procedurave të ndërmarra nga monitoruesit, kanë vepruar në pajtim me Ligjin duke ndërprerë operimin ilegal dhe duke aplikuar për licencë të KPM-së.

Shfrytëzimi i infrastrukturës së operatorëve kabllor ka mundësuar monitorimin në vazhdimësi edhe të 22 ofruesve të shërbimeve programore të cilët barten përmes O.K. Këto monitorime ishin edhe më intensive në kohën e mbajtjes së ndeshjeve të kualifikimeve për kampionatin botëror të futbollit dhe ligave të huaja futbollistike (monitorime lidhur me pajtueshmërinë me të drejtën e transmetimit).

Nisma e Zyrës së Komisionit të Pavarur për Media për amendamentimin e Rregullës për Reklamim ishte obligim shtesë për monitorimin e të gjitha subjekteve transmetuese lidhur me pajtueshmërinë me këtë Rregullore.

Monitorimi i pajtueshmërisë me Rregullën për Reklamim CIMC 2007/04

Në periudhën maj-qershor 2009 është kryer një projekt voluminoz i monitorimit njëmuajorë të tri televizioneve nacionale. Monitorimi i pajtueshmërisë me Rregullën për Reklamim është bërë edhe për televizionet lokale. Gjatë të gjitha monitorimeve janë gjetur përqindjet e reklamave të transmetuara brenda një ore. Krahas kësaj, monitorimi është bërë edhe për vendosjen e produkteve në serialet vendore të transmetuara në tri televizionet nacionale

Monitorimi i RTK

Bazuar në praktikat Evropiane, transmetuesit publik kanë obligime të qarta karshi publikut. Një prej obligimeve të RTK-së, që del nga Neni 6.6 i Ligjit për RTK-në, është transmetimi i programeve në gjuhët e minoriteteve. Pajtueshmëria e Televizionit Publik të Kosovës me Ligjin për RTK-në respektivisht nenin 6.6 të këtij ligji ishte prandaj theksi i monitorimeve të bëra njëmuajore

lidhur me sasinë e programeve të transmetuara në RTK, në gjuhën e minoriteteve. Ky monitorim është bërë për periudhën prill-qershor 2009. Bazuar në monitorimin e bërë për këtë periudhë dhe përqindjen e programeve të minoriteteve të përllogaritura nga skemat programore të Radio Kosovës dhe Radio Blue Sky, Divizioni i Monitorimit ka gjetur se përqindja e programeve për minoritete të transmetuara në Radio Televizionin Publik të Kosovës në periudhën monitoruese ishte 11.29% e jo 15% siç është e paraparë me Ligjin për RTK-në.

Pasi që gjetjet e DMPM për përqindjen e programeve minoritare nuk korrespondojnë me të dhënat e RTK-së për këto programe në raportin vjetor, nga RTK janë kërkuar të dhëna lidhur me përqindjen e programeve të transmetuara për komunitetet si dhe mënyrën e përllogaritjes së tyre. Sipas shpjegimeve të dhëna nga RTK, në përllogaritjen e programeve të transmetuara nuk përfshihen programet e reprizuara pas mesnatës, prandaj në këtë sasi të programit të transmetuar, përqindja e programit të minoriteteve sipas RTK-së është 14.58 %. Sipas RTK-së përqindja nuk është llogaritur për 24 orë transmetimi.

Monitorimi i edicioneve të lajmeve në tri TV stacionet nacionale për 12 muaj

Nga janari deri në fund të vitit 2009, Divizioni i Monitorimit ka bërë monitorime të rregullta të edicioneve qendrore të lajmeve në të tri televizionet nacionale. Tetë parimet⁸ e përcaktuara për vlerësimin e performancës së tri televizioneve nacionale ishin bazë e mirë që koduesit (monitoruesit) përmes shkallës së vlerësimit me pikë nga 1-5 të vlerësojnë performancën e këtyre subjekteve transmetuese duke u bazuar në kritere të njëjta. Këto monitorime janë bërë një herë në muaj. Bazuar në raportet e monitorimit për dymbëdhjetë (12) muaj, është hartuar raporti përmbledhës dhe krahasues për performancën e tri televizioneve nacionale në vitin 2009.

Monitorimet për pajtueshmërinë me rregulloret e KPM-së dhe bazuar në ankesa

Pas miratimit nga Këshilli i KPM-së dhe hyrjes në fuqi të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbytjet e Dëmshme Programore, DMPM ka bërë edhe monitorime lidhur me pajtueshmërinë me këtë Rregullore. Subjektet transmetuese të gjetura në shkelje janë monitoruar përsëri, për të verifikuar nëse ato kanë ardhur në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

DMPM ka bërë gjatë kësaj periudhe monitorime, edhe pas ankesave lidhur me shkeljet e mundshme nga ana e transmetuesve. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij Divizioni pas realizimit të projekteve të lartpërmendura, ishin bazë mbi të cilat Divizionet tjera kanë mbështetur veprimet e tyre.

Në periudhën raportuese stafi i këtij Divizioni ka bërë edhe shumë vizita e inspektime tek radiot, televizionet, operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimeve programore.

Monitorimi i mediave gjatë mbulimit të fushatës elektorale për “Zgjedhjet lokale 2009”

Përderisa në zgjedhjet e kaluara, KPM, në mungesë të kapaciteteve teknike për monitorim dhe atyre njerëzore, ka bërë monitorimet për mbulueshmërinë e fushatës elektorale vetëm në bazë të ankesave të parashtruara, në vitin 2009 DMPM ka monitoruar zgjedhjet lokale 2009 nga 15 tetor deri në përfundim të raundit të dytë të zgjedhjeve, më 13 dhjetor 2009, falë realizimit të projektit kapital që ka mundësuar teknikisht monitorimin e tri (3) televizioneve nacionale, dhjetë (10) TV lokale dhe 2 ofrues të shërbimeve programore. shumicës së tv stacioneve të licencuara. Mediat elektronike për të cilat nuk ka pas mundësi teknike të monitorohen, janë monitoruar bazuar në arkivën e sjellë në rast të ankesave.

KPM është përgjegjës për zbatimin e kreut VIII (Mediat dhe Zgjedhjet) të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet nga të licencuarit (subjektet transmetuese dhe ofruesit e shërbimeve programore). Për t'u siguruar për pajtueshmërinë e të licencuarve me obligimet ligjore, KPM ka nxjerrë edhe udhëzuesit relevantë të cilët para fillimit të fushatës u janë vënë në dispozicion nga Zyra e KPM-së.

⁸ Hierarkija e lajmeve, mbulimi i ngjarjeve relevante, informata dhe fakte të verifikuara, paanshmëria në zgjedhjen e gjuhës dhe imazheve, mbulimi i duhur i institucioneve dhe partive politike, diversiteti i temave dhe prezantimi i përgjithshëm i lajmeve (fotografia, zëri, paraqitja e prezantuesve)

Gjatë këtij monitorimi është bërë analizimi i edicioneve qendrore të lajmeve, kronikave zgjedhore në kohën e shikueshmërisë më të madhe si dhe i reklamave politike lidhur me pajtueshmërinë e tyre me Udhëzuesit për Zgjedhje. Janë bërë gjithashtu matjet e hapësirës së dedikuar secilit entitet politik të certifikuar, duke i vlerësuar dhe kategorizuar këto prezantime si prezantime pozitive neutrale dhe negative.

Zyrtarët e KPM-së nga DMPM kanë analizuar:

- nëse është bërë informimi në mënyrë të drejtë dhe të paanshme për aktivitetet e të gjitha entiteteve politike të certifikuar;
- nëse janë ofruar mundësi të njëjta për të gjitha partitë politike që të promovojnë platformat e tyre politike; dhe
- nëse është vepruar në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet dhe Kodin e Sjelljes për Mediat Elektronike.

Pas monitorimit të performancës së subjekteve transmetuese dhe OSHP-ve gjatë dy raundeve të zgjedhjeve lokale, DMPM ka përgatitur raporte javore dhe raporte përmbljedhëse për dy raundet e zgjedhjeve lokale 2009. Raporti përmbljedhës i monitorimit është dhënë në Shtojcën II të raportit.

DIVIZIONI I LICENCIMIT

Subjektet Transmetuese

Përderisa në vitin 2008 operonin 113 subjekte transmetuese, në Republikën e Kosovës në vitin 2009 kanë operuar 110. Tri subjektet transmetuese (1 TV dhe 2 Radio stacione) për shkaqe financiare kanë hequr dorë nga licenca e transmetimit në vitin 2009.

Nga 110 subjekte të licencuara, prej tyre 66 subjekte transmetuese janë në gjuhën shqipe, 32 në gjuhën serbe, 3 në gjuhën boshnjake, 3 në gjuhën turke, 2 në gjuhën gorane, 1 në gjuhën rome dhe 3 subjekte transmetuese janë multietnike.

Sipas *ndarjes në kategori (Radio dhe TV)*, 21 prej tyre janë televizione: 3 nacionale, 15 lokale dhe 3 TV stacione me fuqi të ulët, ndërsa 89 janë radio stacione: 4 nacionale, 70 lokale dhe 15 janë radio stacione me fuqi të ulët.

Në ndarjen sipas regjioneve: në Gjilan operojnë 33 subjekte transmetuese, në Mitrovicë 19 subjekte transmetuese, në Pejë 13 subjekte transmetuese, në Prishtinë 25 subjekte transmetuese dhe në Prizren 20 subjekte transmetuese.

Ofruesit e Shërbimeve Programore- OSHP

Gjithsej në Kosovë operojnë 28 OSHP të licencuar, 15 prej tyre janë licencuar gjatë vitit 2009. Këta OSHP programin e tyre e transmetojnë përmes rrjetit të operatorëve kabllorë. Pjesa më e madhe e OSHP-ve të licencuara kanë selinë në Prishtinë, ndërsa pjesa tjetër në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Operatorët Kabllorë

Gjatë vitit 2009 KPM ka licencuar 3 operatorë kabllor (1 nga këta operator u ofron shërbimet e klientëve të tij në lokalitetin e banuar me pjesëtarë të minoritetit serb, 1 në lokalitetin e banuar me pjesëtarë të minoritetit goran, kurse 1 në lokalitetin e banuar me shqiptarë).

Në Kosovë janë të licencuar gjithsej 10 operatorë kabllor të cilët ofrojnë shërbimet e tyre kabllore në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës. Dy nga këta janë operatorë kanë zgjeruar rrjetin e tyre dhe aktualisht operojnë në disa komuna të Kosovës.

DIVIZIONI LIGJOR

Ky divizion gjatë vitit 2009 ka shqyrtuar raste të ndryshme të subjekteve transmetuese, ofruesve të shërbimeve programore dhe operatorëve kabllorë për shkelje të Ligjit të KPM-së dhe akteve nënligjore të KPM-së. Po ashtu janë shqyrtuar edhe ankesa të personave fizik e të organizatave të ndryshme që i janë drejtuar KPM-së, ndaj mediave elektronike.

Varësisht nga lloji i shkeljes së dispozitave ligjore të KPM-së, rastet e proceduara janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

1. Rastet për transmetim ilegal

Gjatë vitit 2009, janë proceduar tre (3) raste për shkeljen e nenit 11.1, Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon Komisioni”*, dhe neni 20.5 i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë nuk mund të ankohet tek Bordi i Ankesave për Media”*.

Rastet e proceduara për shkeljen e dispozitave të lartë përmendura janë të paraqitura në tabelën 1 të shtojcës V të këtij raporti dhe kanë të bëjnë me dy (2) operatorë ilegal kablor në regjionin e Prizrenit, njëri në Lubinjë të Epërme e tjetri në Zhur. Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, operatorët ilegal kanë ndërprerë transmetimin. Rastet janë mbyllur.

Rasti i tretë ka të bëjë me një radio lokale e identifikuar si Radio Gjilani. Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, pala ka ndërprerë transmetimin. Rasti është mbyllur.

2. Rastet për shkelje të Rregullës për Reklamim 2007/06

Divizioni Ligjor gjatë vitit 2009 ka proceduar gjashtë (6) raste⁹ kundër subjekteve transmetuese që janë gjendur në shkelje të Rregullës për reklamim:

- TV 21 dhe Radio Televizioni i Kosovës - RTK, kanë bërë shkelje të nenit 10.3 pika d) të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetuese CIMC-2007/06, mosidentifikim përkatës të vendosjes së produkteve në fillim, pas ndërprerjeve dhe në përfundim të emisionit. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, kanë arritur të jenë në pajtueshmëri me Rregullën në fjalë.
- Radio Televizioni i Kosovës – RTK, TV 21 dhe KTV – Koha Vision dhe RTV Mitrovica kanë bërë shkelje të nenit 11.1 të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetuese CIMC-2007/06, tejkalim i përqindjes së kohës, të lejuar për reklamim. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, subjektet transmetuese kanë ardh në pajtueshmëri me Rregullën në fjalë.

3. Rastet për shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

3.1 Transmetimet pa të drejtë autoriale

Edhe gjatë vitit 2009, problemi i respektimit të të drejtës autoriale ka qenë problem kyç si për industrinë mediale edhe për rregullatorin. Mungesa e një institucioni përkatës për zbatimin e Ligjit mbi të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e Përafërta, i cili është shpallur në gusht 2006, vështirëson edhe më shumë punën e KPM-së pasi që mbetet vetëm KPM të merret me çështjet e respektimit të së drejtës autoriale nga subjektet transmetuese.

⁹ Këto raste janë të paraqitura në Tabela-2 të shtojcës V (Tabela e rasteve ligjore të proceduara gjatë vitit 2009)

Subjektet transmetuese së bashku me operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimit të programeve e kanë obligim sipas Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së që të respektojnë të drejtën e autorit dhe të sigurojnë kontrata valide për transmetimin e programeve komerciale dhe për kanalet e ritransmetuara (operatorët kabllorë).

Divizioni Ligjor gjatë vitit 2009 ka proceduar 17 raste¹⁰ për shkelje të së drejtës autoriale:

- Nëntë (9) raste ligjore të iniciuara ndaj subjekteve transmetuese të cilat edhe përkundër pranimit të Njoftimeve për Shkelje, dështuan të jenë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës – kapitulli për të drejtën Autoriale, janë sanksionuar me gjobë. Tetë (8) nga këto raste janë të përfunduara – mbyllura.
- Rastet ligjore ndaj "Eagle"- Operator Kabllor në Prizren dhe TV MEN – Televizion lokal në Gjilan, lidhur me Shkeljen e nenit 2.1.3 dhe 2.1.5. përkatësisht 4.1.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës janë në procedurë dhe monitorim të vazhdueshëm. Ndaj palëve janë iniciuar procedura ligjore, me ç' rast OK "Eagle" edhe është sanksionuar me gjobë.

Për shkelje të njëjta të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës janë iniciuar raste ndaj gjashtë (6) subjekteve transmetuese të cilat pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje janë mbyllur pasi që palët kanë ardhur në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

3.2 Mosmbajtja e arkivës

Dështimi i Palëve Përgjegjëse për sjelljen e materialit të arkivuar programor sipas kërkesës së KPM-së, ka rezultuar me iniciimin e katër (4) rasteve¹¹ ligjore, ndaj TV MEN - Televizion Lokal në Gjilan (në dy raste), RTK dhe TV Opinion nga një rast. Pas pranimit të Njoftimit për Shkelje, palët kanë ardhur në pajtueshmëri, kështu që rastet janë mbyllur.

4. Rastet për shkelje të Rregullores CIMC 2009/01 – për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore

Divizioni Ligjor gjatë vitit 2009 ka proceduar 12 raste¹² lidhur me shkeljen e Rregullores CIMC 2009/01. Për të gjitha rastet e evidentuara, subjekteve iu është dërguar Njoftim për Shkelje. Rastet janë në procedim e sipër.

5. Rastet për shkelje të Vendimit CIMC-2008/01 për Subjekte Transmetuese - Mospagesa e taksës për licencë

Divizioni Ligjor gjatë vitit 2009 ka proceduar katër (4) raste¹³ lidhur me këtë shkelje, të cilave u është dërguar Njoftim për Shkelje.

6. Rastet për shkelje të Vendimit CIMC-2007/05 për OSHP dhe OK - Mospagesa e taksës për licencë

Divizioni Ligjor gjatë vitit 2009 ka proceduar tetë (8) raste¹⁴ lidhur me këtë shkelje:

- Këshilli i KPM-së mori vendim për pezullim të licencës së OSHP "ZICO TV" dhe "ZICO TV 2" për periudhë një mujore për shkak të mos-pagesës së taksës për Licencë. Rastet janë në procedurë.
- Pas Njoftimit për Shkelje, operatori kabllor "EAGLE", OSHP "Business Channel" dhe OSHP "Visa Channel", kanë paguar taksën për licencë. Rastet janë mbyllur.

¹⁰ Këto raste gjenden në Tabelën 3 të shtojcës V

¹¹ Këto raste gjenden në Tabelën 4 të shtojcës V

¹² Këto raste gjenden në Tabelën 5 të shtojcës V

¹³ Këto raste gjenden në Tabelën 6, shtojca V

¹⁴ Këto raste gjenden të përshkruara në mënyrë më të detajuar Tabela 7, shtojca V

- Këshilli i KPM-së mori vendim për pezullim të licencës së OK "Digit", OSHP "Zero TV" dhe OSHP "Infinit TV" për periudhën një mujore. Rastet janë në procedurë.

7. Rastet për shkeljen e Ligjit Nr. 03/L-73 për Zgjedhjet e përgjithshme

Shkelja e nenit 49.7 - Mos dorëzimi i ditarëve për zgjedhje

Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009, Divizioni Ligjor ka proceduar tridhjetë e pesë (35) raste¹⁵ lidhur me këtë shkelje. Pas Njoftimeve për Shkelje subjektet transmetuese kanë ardh në pajtueshmëri me nenin 49.7 të Ligjit për Zgjedhje, duke ofruar Ditaret apo Shkresat Njoftuese me të cilat kanë njoftuar se nuk kanë transmetuar reklama politike.

Shkelja e Heshtjes Zgjedhore

Bazuar në nenin 51.1 të Ligjit për Zgjedhje të përgjithshme janë proceduar 7 raste¹⁶ lidhur me shkeljet e Udhëzuesit nr. 3 gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore të mediave. Të gjitha rasteve të evidentuara Këshilli i KPM-së ju ka vendosë masën Vërejtje konform Ligjit të KPM-së.

Shkelje e nenit 49, pika 5 - Reklamimi politik në kuadër të edicionit të lajmeve

Për shkeljen e nenit 49.5 janë proceduar dy raste¹⁷, TV Men dhe TV Liria. Pas Njoftimeve për Shkelje këto subjekte transmetuese kanë ardh në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

Shkelje e nenit 48 - Mos-ofrim i hapësirës gjatë periudhës zgjedhore

Janë proceduar dy raste¹⁸ në lidhje me këtë Shkelje - TV OPINION dhe RADIO HAYAT. Pas dërgimit të njoftimeve për shkelje palët kanë ardh në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur.

Raste dhe Kërkesa tjera të proceduara nga KPM¹⁹

Janë proceduar tre (3) raste: Rasti i parë është proceduar bazuar në kërkesën e Partisë Boshnjake SDP për sigurim të një termini në Radio Hayat, KPM është përgjigjur se nuk është në mandat të saj ndërhyrja në politikën redaktuese të subjekteve transmetuese. Ndërsa në dy rastet tjera, KPM ka udhëzuar palët ankuese të kërkojnë të drejtën për demant tek subjektet relevante transmetuese, në pajtim me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

DIVIZIONI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Gjatë vitit 2009, DMF-ja ka shqyrtuar/proceduar raste të interferencave, ndërrim kanali të TV-ve, ndërrim të frekuencave të radiove, ndërrim të lokacionit, zgjerim të zonës së mbulimit, rritje të fuqisë së transmetimit etj.

Në rast të interferencave, pas pranimit të ankesës, DMF-ja bën matje teknike në teren dhe matë fuqinë e sinjalit të interferencës dhe me ndihmën e pajisjeve të monitorimit identifikon burimin e interferencës. Në rastet kur shkak i interferencës është një subjekt transmetues i licencuar brenda Kosovës, DMF-ja kontakton subjektin transmetues dhe këshillon atë të kontrollojë sistemin e transmetimit apo kur subjekti transmetues nuk është në pajtueshmëri me kushtet dhe termet teknike të licencës, KPM-ja urdhëron subjektin transmetues që shkakton interferencë, që të sillet në pajtueshmëri duke i dhënë instruksione të qarta se si ta bëjë atë.

Rastet për interferenca, ndërrim lokacioni dhe transmetim ilegal

Gjatë vitit 2009 janë proceduar gjithsej tetë raste për ndërhyrje dhe të gjitha këto raste janë përfunduar me evitimin e problemit. Nga këto subjekte transmetuese pesë kanë qenë radio dhe tri

¹⁵ Rastet janë të paraqitura në Tabelën Nr. 8 të shtojcës V.

¹⁶ Rastet janë dhënë në Tabelën 9 të shtojcës V

¹⁷ Tabela 10 shtojca V

¹⁸ Tabela 11 shtojca V

¹⁹ Tabela 12 shtojca V

TV. Një rast ka qenë për ndërrim lokacioni të transmetuesit të një radio stacioni lokal, pa ndryshuar zonën e mbulueshmërisë.

Gjatë monitorimit në këtë periudhë është identifikuar vetëm një rast për transmetim ilegal në Gjilan. Pas intervenimit të KPM-së dhe njoftimit të KPM-së për statusin e subjekteve ilegale dhe masave të mundshme që mund të mirrën ndaj tyre, transmetimi është ndërprerë.

Gjatë matjeve dhe analizave të bërë nga DMF, sidomos pas vendosjes së filtrave nga subjektet transmetuese është konstatuar se në përgjithësi gjendja në transmetimin radiodifuziv të Kosovës është stabile.

Transmetimi në valë të mesme AM

Të gjitha subjektet transmetuese radio në Kosovë transmetojnë në brezin frekuencor VUSH/FM (Valë Ultra të Shkurtra) nga 87.5 MHz - 108 MHz. Në mesin e këtyre radiostacioneve Radio Kosova transmeton programin e vet edhe në valë të mesme AM përkatësisht në frekuencën 549 KHz, në të cilën frekuencë transmeton kryesisht program në gjuhën e minoriteteve. Pas ankesave të paraqitura nga pjesëtarë të minoriteteve, DMF ka bërë monitorim të brezit frekuencor AM për të verifikuar bazueshmërinë e ankesave dhe ka gjetur se Radio Kosova transmeton programet në gjuhë të minoriteteve vetëm në frekuencë të valëve ta mesme e cila nuk ka kualitetin si FM. Më saktësisht, nga matjet e bëra është gjetur që në rrethinë të Prishtinës, Radio Kosova shfrytëzon frekuencat lokale në brezin FM (91.9; 93.3 dhe 99.2 MHz) dhe në brezin radio të valëve të mesme AM (549 KHz). Po ashtu, Radio Kosova përdor frekuencat nacionale FM (95.7 MHz ; 97.7 MHz).

Frekuencat - 91.9 MHz transmetonin programin e Radio Kosovës, 93.3 MHz transmetonin programin e Radio Blue Sky, ndërsa frekuencat 99.2 MHz dhe 549 kHz transmetonin programin në gjuhë boshnjake dhe rome deri në ora 15:00, gjegjësisht pas orës 15:00 programi i njëjtë transmetohej në frekuencat: 95.7 MHz; 91.9 Mhz; 99.2 MHz dhe 549 kHz (valë të mesme).

KPM ka kërkuar nga Radio Kosova sqarime lidhur me këtë, pse programi në gjuhët e minoriteteve nuk transmetohet në FM në frekuencat e caktuara për mbulim nacional por vetëm në valë të mesme. Sqarimi i RTK-së ka qenë që nuk kanë frekuenca të mjaftueshme në brezin FM për të ndarë programet prandaj janë të detyruar ta shfrytëzojnë këtë brez AM.

Frekuencat në shfrytëzim nga UNMIK-u dhe KFOR-i

Përdorimi i katër frekuencave FM nga UNMIK pa licencë të KPM-së

Nga monitorimet e bëra është gjetur se UNMIK-u vazhdon edhe më tutje të shfrytëzon frekuencën 106.5 MHz për mbulim të regjionit të Mitrovicës dhe frekuencën 107.2 MHz për mbulim të Prishtinës, Pejës, Gjilanit dhe shumë më gjerë. Në fillim të vitit 2008, UNMIK ka njoftuar KPM që do të përdor këto katër frekuenca dhe ka kërkuar asistencë nga KPM për shfrytëzim të tyre. KPM ka kërkuar që këto frekuenca të kthehen pas përfundimit të misionit të UNMIK-ut, respektivisht në kohën kur KPM do të bëjë ri-licencimin.

Shfrytëzimi i frekuencave nga KFOR-i

KFOR-i pos shfrytëzimit të frekuencave për radio dhe TV, shfrytëzon si pikë transmetimi edhe Majën e Goleshit, e cila nuk shfrytëzohet nga mediat kosovare. KPM disa herë i është drejtuar me shkrim KFOR-it duke ngritur si çështje problematike që kërkon zgjidhje emergjente problemin me pikat e transmetimit të Goleshit dhe Cvilenit, të cilat nuk janë në shfrytëzim nga subjektet transmetuese kosovare. Shfrytëzimi i pjesës së sipërme të Goleshit do t'u mundësonte mediave transmetuese, radio dhe TV, që të mbulojnë afërsisht edhe 12% më tepër të popullatës së Republikës së Kosovës (d.m.th. do të zgjidhej edhe çështja e mbulimit të RTK-së siç është e obliguar me ligj). Përdorimi i kësaj pjese do të mundësonte edhe mbulimin e pjesës veriore të Kosovës, të banuar kryesisht me popullatën minoritare serbe. Sipas KFOR-it, kjo pikë strategjike

nuk do të mund të shfrytëzohet për shkaqe sigurie. Këshilli i KPM-së këtë problem e ka ngritur edhe me Presidentin e Republikës së Kosovës nga i cili, përmes një shkrese, ka kërkuar që në komunikimet e tij të rregullta me KFOR-in të diskutojë edhe për funksionalizimin dhe shfrytëzimin e pikave strategjike transmetuese siç janë Cvileni dhe Goleshi të cilat janë në shfrytëzim të KFOR-it që nga operimi i këtij mekanizmi ndërkombëtare në Kosovë.

Operatorët kabllor

Monitorime teknike lidhur me shfrytëzimin e brezave frekuencore (VHF/UHV/TV) për transmetim tokësor nga ana e operatorëve kabllor Kujtesa dhe Ipko, nga është vërejtur se Kujtesa dhe Ipko kanë qenë duke transmetuar disa programe televizive jashtë brezit frekuencor S. Në vendet urbane ku kanë digjitalizuar transmetimin e programeve ky problem nuk paraqitet më.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Buxheti

Komisioni i Pavarur për Media është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Për vitin 2009 KPM-së i është ndarë buxhet prej 1,000,576.00 Euro duke përfshirë të hyrat vetanake prej 131,160.00 euro dhe investimin kapital prej 450,000.00 Euro.

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009			
Kategoritë	Buxheti i alokuar/aprovuar	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Paga dhe mëditje	141,688.00	139,673.00	2,016.00
Mallra dhe shërbime	257,728.00	254,170.00	3,558.00
Shërbime komunale	20,000.00	13,343.00	6,656.00
Të Hyra vetanake	131,160.00	130,730.00	430.00
Shpenzimet kapitale	450,000.00	440,412.00	9,588.00
Total	1,000,576.00	978,328.00	22,248.00

Realizimi i projekteve kapitale

Gjatë vitit 2009 janë realizuar dy Projekte Kapitale:

1. Automjet me pajisje digjitale për monitorimin e subjekteve transmetuese është realizuar me 399,600.00 euro nga 400,000.00 euro; dhe
2. Ripërtirja e Pajisjeve të IT-së është realizuar me 40,812.00 euro nga 50,000.00 euro.

Buxheti i KPM-së është realizuar për 97%. Në shtojcën I është dhënë raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa.

Memorandumi i Mirëkuptimit – Të hyrat nga taksat për licencë

Në bazë të nenit 5 (1,2) të Ligjit të Buxhetit 03/L-105, neni 5 pika (b dhe c) neni 16.1 të Ligjit të Kuvendit Nr. 02/L-15 mbi KPM-në dhe Transmetim, i shpallur dhe plotësuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/34 autorizon KPM-në të caktojë tarifa vjetore për licencat e transmetimit. Komisioni i Pavarur për Media ka përgatitur Marrëveshjen e Memorandumit të Mirëkuptimit për të hyrat vetanake për vitin 2009.

Për vitin 2009 janë parashikuar të hyra 143,228.00 € prej tyre 93,780.00 € nga Subjektet Transmetuese, 9,945.00 € nga Ofruesit e Shërbimeve Programore, 39,503.00 € nga Operatorët

Kabllor, kurse me vonë janë planifikuar edhe 10,645.55 € nga Aplikuesit për rilicensim dhe shuma e përgjithshme është rritur në 96,874.90 € Arsyeja e tejkalimit të planit ka qenë numri i licencave të lëshuar për Ofruesit e Shërbimeve Programore.

Ndërsa gjatë këtij viti KPM-ja ka arritur të mbledh këto të hyra të planifikuara në këto shuma:

Nga të hyrat vetanake në vitin 2009 të mbledhura prej taksës së licencës nga subjektet transmetuese janë gjeneruar 240,102.90 euro. Me Marrëveshjen e Memorandum Mirëkuptimit për KPM janë ndarë 131,160.00 euro. Prej tyre janë shfrytëzuar 130,730.00 euro për: Angazhimin e ekspertëve ndërkombëtar dhe vendor, Hulimtim/ Analiza të sektorit medial, Grupet Punuese për legjislacione dhe Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare për Digjitalizimin e Mediave.

Raporti i të hyrave nga taksa për licencë duke përfshirë edhe gjobat

	Të planifikuara	Të hyra	përqindja e arritshmëris
Subjekte transmetuese	93,780.00 €	110,819.65 €	118.17 %
Operator Kabllor	39,503.00 €	44,245.22 €	112.00 %
Ofrues të shërbimeve programore	9,945.00 €	73,401.38 €	738.07 %
Aplikim për licencë		1,100.00 €	
Aplikim për rilicensim		10,536.65 €	98.98 %
Totali	143,228.00 €	240,102.90 €	156.04 %
Gjoba		44883.32 €	
Totali		284,986.22 €	

PREZANTIMI I PUNËS SË BORDIT PËR ANKESA TË MEDIAVE (BAM)

Bordi për Ankesa të Mediave (“BAM”) është organ i pavarur i themeluar në pajtim me nenin 21 të Ligjit të KPM-së. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me vendimet e Këshillit të KPM-së.

Seancat e BAM-it dhe Vendimet

Bordi i Ankesave për Media (“BAM”) gjatë vitit 2009 ka shqyrtuar gjithsej 8 ankesa ndaj vendimeve të Këshillit të KPM-së. BAM-i është takuar tri herë, në mars, prill dhe në qershor.

Palët të cilat janë ankuar ndaj vendimeve të Këshillit të KPM-së gjatë vitit 2009;

1. Subjekti Transmetues TV EJA
2. Subjekti Transmetues Syri Vizion
3. Subjekti Transmetues TV Besa
4. Operatori Kabllor IPKO
5. Operatori Kabllor Tele Net
6. Operatori Kabllor EAGLE
7. Ofruesi i Shërbimeve Programore Klan Kosova
8. Ofruesi i Shërbimeve Programore Zero TV.

BAM-i në seancën e muajit mars të vitit 2009 ka shqyrtuar ankesën e një subjekti transmetues kundër Vendimit të Këshillit të KPM-së për dhënien e licencës, BAM-i e ka vërtetuar vendimin e Këshillit si të ligjshëm.

BAM po ashtu është takuar edhe në muajin mars ku ka shqyrtuar dy ankesa të Operatorëve Kabllor kundër vendimeve të Këshillit. BAM në këtë seancë ka vendosur t’i ndryshoj vendimet e Këshillit.

BAM në seancën e fundit të vitit 2009 në qershor, ka shqyrtuar pesë ankesa, prej tyre dy të televizioneve, dy të Ofrueseve të Shërbimeve Programore, dhe një Operatori Kabllor. BAM në këtë seancë ka hedhur poshtë dy ankesa si të pa baza, ka vërtetuar një vendimi të Këshillit të KPM-së si dhe ka ndryshuar dy vendime tjera.